



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 8 Shkurt 2022

Nr: 15

V E N D I M

P Ë R

**MIRATIMIN E UDHËZUESIT TË PUNËS PËR KOMISIONET E QENDRAVE TË VOTIMIT
PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR NË BASHKITË SHKODËR, DIBËR,
DURRËS, VORË, RROGOZHINË DHE LUSHNJË, QË DO TË ZHVILLOHEN MË DATË 6
MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 13 438, datë 20.01.2022, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore”, të nenit 20, pika 1, shkronja “gj”, neneve 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42 dhe nenit 43 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I :

1. Të miratojë Udhëzuesin e Punës për Komisionet e Qendrave të Votimit, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO – Kryetare

Arens ÇELA – Anëtar

Dritan ÇAKA – Anëtar

Helga VUKAJ – Anëtare

Muharrem ÇAKAJ - Anëtar



Data: 8 Shkurt 2022

Nr. 15

“Për miratimin e Udhëzuesit të Punës për Komisionet e Qendrave të Votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”

UDHËZUESI I PUNËS PËR KOMISIONET E QENDRAVE TË VOTIMIT
PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR NË BASHKITË SHKODËR,
DIBËR, DURRËS, VORË, RROGOZHINË DHE LUSHNJË,
QË DO TË ZHVILLOHEN MË DATË
6 MARS 2022

Përmbajtje

Mesazh i mirëseardhjes	1
I.Rregulla të etikës	2
II. Rregulla në kushtet e pandemisë COVID.....	2
III.Përbërja e KQV-së dhe vakancat e mundshme	3
IV.Detyrat e Komisionit të Qendrës së Votimit.....	3
V.Mbledhjet dhe vendimet e KQV-së	4
VI.Dokumentacioni i KQV-së dhe vulat	4
VII.Veprimtaria e KQV-së një ditë para zgjedhjeve.....	5
1.Marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore dhe dokumenteve të tjera.....	5
2.Dërgimi i materialeve zgjedhore në qendrën e votimit	6
VIII.Veprimtaria e KQV-së në ditën e votimit.....	7
1.Veprimet paraprake të KQV në ditën e votimit	7
2.Veprimet paraprake të KQV-së për hapjen e votimit.....	7
3.Procedura e votimit	8
4.Veprime të KQV kur PEI nuk punon.....	9
5.Mbyllja e votimit.....	10
6.Veprimet pas mbylljes së votimit.....	11
IX.Rregulla në qendrën e votimit	11
X.Raste të veçanta votimi	12
XI.Veprimet që çënojnë procesin e votimit.....	13
Skema orientuese e KQV.....	15

**UDHËZUESI I PUNËS PËR KOMISIONET E QENDRAVE TË VOTIMIT PËR
ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR NË BASHKITË SHKODËR, DIBËR,
DURRËS, VORË, RROGOZHINË DHE LUSHNJË, QË DO TË ZHVILLOHEN MË
DATË 6 MARS 2022**

Mesazh i mirëseardhjes!

Të nderuar anëtarë e sekretarë të KQV!

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ju uron suksese në përmbushjen e detyrës së rëndësishme për zhvillimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit duke zbatuar detyrat sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të nxjerra nga KQZ për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie në disa njësi të qeverisjes vendore, të datës 6 mars 2022.

Detyrat tuaja ju duhet t’i zbatoni me profesionalizëm, etikë dhe standarde të larta, për të garantuar që çdo zgjedhës të ushtrojë lirisht të drejtën e votës së lirë, të fshehtë, të barabartë, të drejtëpërdrejtë. Ky udhëzues është hartuar për t’u ardhur në ndihmë duke përcaktuar disa prej detyrave tuaja më kryesore.

Anëtari i administratës zgjedhore gjatë ushtrimit të detyrës duhet të dëshmojë marrëdhënie besimi për zgjedhësit, në shërbim të interesit publik, për zgjedhje të lira dhe të ndershme, e ndërtuar mbi parimet:

- ✓ Parimi i ligjshmërisë dhe paanësisë, ku çdo shtetas që emërohet dhe merr pjesë në administrim zgjedhor, vepron në përputhje të plotë me Kodin Zgjedhor, aktet nënligjore të KQZ-së, dhe me rregullat për parandalimin e konfliktit të interesave.
- ✓ Parimi i unitetit dhe hierarkisë, administrata zgjedhore organizohet në mënyrë të atillë që çdo nivel i saj të mbikqyret, monitorohet dhe përgjigjet tek niveli më i lartë.
- ✓ Parimi i efektivitetit, administrata zgjedhore duhet të sigurojë efikasitetin në kryerjen e funksioneve dhe detyrave me profesionalizëm.
- ✓ Parimi i barazisë, administrata zgjedhore organizohet që t’u shërbejë me të njëjtën cilësi dhe transparencë të gjithë zgjedhësve dhe subjekteve zgjedhore.
- ✓ Parimi kolegjalitetit, çdo anëtar i administratës zgjedhore, bashkëpunon me anëtarët e tjerë të komisionit apo strukturës ku bën pjesë për arritjen e objektivave ligjorë që u janë besuar, në përputhje me ligjin.

Njohja dhe përvetësimi i kuadrit ligjor zgjedhor, profesionalizmi dhe pavarësia në përmbushjen e detyrave, me paanësi, transparencë të plotë, dhe kolegjalitet, janë çelësi i suksesit për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në zonën e administrimit zgjedhor.

Ju urojmë punë të mbarë!

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KQV përgjigjet për zhvillimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të nxjerra nga KQZ si dhe zbatimin e rregullave të përcaktuara nga KQZ për mënyrën e venies në funksion të pajisjes së teknologjisë së informacionit dhe sistemit të video regjistrimit (PEI dhe kamera);

Ky Udhëzues, përdoret nga anëtarët e KQV-së si udhërefyës për punën e tyre, një ditë para ditës së zgjedhjeve dhe gjatë ditës së votimit.

I. Rregulla të etikës

Komisioni i qendrës së votimit, gjatë kryerjes së detyrës zbaton parimet e administrimit të zgjedhjeve, për legjitimitet, transparencë, paanshmëri, profesionalizëm në përputhje me Kodin Zgjedhor, aktet e KQZ-së, vendimet e KZAZ-së dhe vendimet e KQV-së.

Anëtarët e komisionit të qendrës së votimit, të cilët detyrimisht duhet të marrin pjesë në trajnimet e KQZ-së duhet të shmangin konfliktin e interesit dhe ta deklarojnë atë. Ndershmëria, korrektësia, përkushtimi, etika në komunikim janë tipare të rëndësishme për anëtarin e Komisionit të qendrës së votimit. Veprimtaria e tij ushtrohet në respekt të interesit publik.

Në ushtrimin e detyrës, anëtarët e komisionit të qendrës së votimit, edhe pse i përkasin një partie politike të caktuar, duhet të udhëhiqen nga interesi publik dhe të trajtojnë në mënyrë të barabartë dhe të drejtë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor pa i dhënë avantazh ndonjë partie politike apo grupi interesi. Ata nuk duhet të shprehin ngjyra partiake, simbole apo shenja dalluese të tyre.

Komisioni i Qendrës së votimit duhet të shmangë dhe të deklarojë rrethanat që e çojnë atë në kushtet e konfliktit të interesit si dhe shkeljet që sjellin shakrkimin e tij.

II. Rregulla në kushtet e pandemisë COVID

Anëtarët e KQV-së, çdo zgjedhës, vëzhgues i akredituar, punonjës i Policisë së Shtetit në detyrë, në mjedisin e QV-së duhet të përdorin mjetet mbrojtëse për shëndetin, maskë higjienike, dezinfektues dhe të respektojnë rregullat anti Covid si dhe të zbatojnë rregullat e higjienës dhe

distancimit fizik në përputhje me rregullat dhe protokollet e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

III. Përbërja e KQV-së dhe vakancat e mundshme

KQV përbëhet nga shtatë anëtarë, ku një anëtar ushtron detyrën e sekretarit. Anëtarët dhe sekretari i KQV-së emërohen nga KZAZ, vetëm për periudhën e zgjedhjeve. Kryetari dhe sekretari i KQV-së zgjidhen nga KZAZ-ja. Sekretari është i përkatësisë politike të kundërt me kryetarin, sipas rastit përfaqësues i partisë kryesore të shumicës ose opozitës parlamentare. Sekretari i KQV-së, si rregull, ka arsimin e lartë.

KZAZ, me vendim mund të shkarkojë anëtarin apo sekretarin e KQV-së apo mund t'i lirojnë atë nga detyra, të cilët nuk mund të rizgjidhen më në këtë detyrë. Secili prej tyre mund edhe të dorëhiqet.

Në rast se KQV është në kushtet e vendeve vakante, kushdo nga KQV njofton menjëherë KZAZ-në, përmes telefonit celular, mesazhit zanor apo tekstit të shkruar, për mungesën, dorëheqjen, shkarkimin apo lirimin e anëtarëve. Mungesa e anëtarit/ëve një orë para hapjes së votimit ose largimit gjatë ditës së votimit njoftohet menjëherë. Kuorumi për veprimtarinë e KQV-së është 4 anëtarë.

Anëtari i dorëhequr apo i liruar nga detyra nuk largohet pa dorëzuar detyrën tek zëvendësuesi.

Sekretari dokumenton, regjistron dhe shënon në librin e protokollit të mbledhjeve të gjitha detajet e njoftimit të vakancës nga KQV, si dhe përgjatë veprimtarisë së KQV, çdo kërkesë, shkresë apo deklaratë. Në rast të mungesës së kuorunit, KQV njofton KQZ dhe KZAZ dhe vazhdon procedurat pavarësisht kuorunit vetëm pas urdhërit të KZAZ.

IV. Detyrat e Komisionit të Qendrës së Votimit

Detyrat e kryetarit dhe të sekretarit të KQV janë të përcaktuara në nenin 36 të Kodit Zgjedhor si dhe në vendimin e Komisionit Rregullator “Për mënyrën e ngritjes, organizimit, funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në Qendrën e Votimit”.

Kryetari i KQV drejton veprimtarinë e KVQ që nga dita e ngritjes së saj, marrjen e materialeve zgjedhore dhe teknologjise përkatëse, për fillimin e procesit të votimit në QV, ndjekjen e ecurisë së procesit të votimit me identifikimin e zgjedhësve, në listën e zgjedhësve, vulosjen e fletës së votimit me Vulën e Kryetarit të QV, mbylljen e procesit të votimit, drejton mbledhjet e KQV. Pra në tërësi është përgjegjës për zhvillimin e zgjedhjeve në QV.

Detyrat e sekretarit të KQV janë të përcaktuara në nenin 41 të Kodit Zgjedhor. Në tërësi, detyra e tij lidhet me administrimin e gjithë dokumentacionit ligjor ku bazohet puna e KQV. Puna e tij konsiston në marrjen e materialeve zgjedhore, administrimin e vulës së QV, vulosjen e fletëve të votimit me vulën e QV dhe procesverbaleve e vendimeve të KQV. Ai administron Librin e Protokollit të Mbledhjeve si dhe mban kontakte me KZAZ, me KQZ dhe me operatorin e pajisjes PEI dhe të kameras.

Anetari i KQV është përgjegjës për zhvillimin e zgjedhjeve në QV duke zbatuar detyrat e përcaktuara me Vendim të KQV në funksion të mbarëvatjes së zgjedhjeve në QV.

V. Mbledhjet dhe vendimet e KQV-së

1. Mbledhjet e KQV-së janë publike.
2. Vendimet e KQV-së merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij. Anëtarët që kanë marrë pjesë në votim nënshkruajnë vendimet dhe deklarojnë voton “pro” apo “kundër”. KQV përdor modelet e vendimeve që gjenden në materialet zgjedhore që ata kanë marrë në dorëzim. Të gjitha vendimet regjistrohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.
3. Vendimi i KQV-së është i vlefshëm, edhe kur nuk merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij, por vetëm pas urdhërimit nga KZAZ.
4. KQV merr vetë vendimin për të vijuar votimin pa identifikim elektronik në rast se pajisja PEI nuk është riparuar apo zëvendësuar. Ky vendim merret vetëm pasi kalojnë 3 orë nga koha e njoftimit të asistencës teknike.

VI. Dokumentacioni i KQV-së dhe vulat

KQV-ja ka në dispozicion të tij dokumentacionin e miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Në dokumentacionin e punës të KQV-së përfshihen modelet e vendimeve dhe të procesverbaleve të cilat janë të emërtuara dhe pas vendimmarrjes së KQV-së plotësohen nga sekretari dhe nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e KQV. Ky dokumentacion administrohet nga sekretari i KQV-së.

KQV ka në dispozicion edhe Librin e Protokollit të Mbledhjeve, në të cilin sekretari shënon të gjithë veprimtarinë e KQV-së, komunikimet e korrespondencat me KZAZ, incidentet, ankimet e vëzhguesve. Në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së ndodhen modelet e vendimeve dhe procesverbaleve të KQV-së, si dhe deklarata e personit që ndihmon një zgjedhës për të votuar. Regjistri i posaçëm i zgjedhësve është regjistri në të cilin shënohen raste të veçanta të votimit për zgjedhës që nuk e kanë emrin në listën e zgjedhësve të qendrës së votimit.

Vula e KQV me tekstin “KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT” dhe numrin e qendrës përkatëse të votimit përdoret dhe administrohet nga sekretari. Me të vulozet pjesa e pasme e fletës së votimit dhe të gjitha vendimet e procesverbalet e KQV-së. Vula e kryetarit me tekstin “KRYETARI” dhe një numër serial përdoret vetëm për vulosjen e fletëve të votimit dhe për asnjë dokument tjetër zgjedhor.

Në rastet e dëmtimit, humbjes apo nxjerrjes jashtë qendrës së votimit të vulës, KQV pajiset me vulë rezervë. Rastet e problematikave me vulën i njoftohen menjëherë KZAZ. Dëmtimi i qëllimshëm ose nxjerrja e vulës jashtë qendrës së votimit përbën vepr penale dhe ndëshkohet sipas nenit 326/a të Kodit Penal. Nxjerrja jashtë përdorimit e vulës bëhet me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndërsa dorëzimi i vulës rezervë bëhet me procesverbalin përkatës.

VII. Veprimtaria e KQV-së një ditë para zgjedhjeve

1. Marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore dhe dokumenteve të tjera

- a) Kryetari dhe sekretari i KQV, një ditë para ditës së zgjedhjeve, jo më vonë se ora 15.00, tërheq nga KZAZ-ja:
 - i kutinë me materialet zgjedhore, përfshirë dhomat e fshehta. Ky veprim dokumentohet me plotësimin, nënshkrimin dhe vulosjen e procesverbalit Model KZAZ 22.

- ii 12 vulat metalike me kode sigurie, prej të cilave 9 me të njëjtën ngjyrë përdoren për mbylljen e kutisë së votimit dhe atë të materialeve zgjedhore dhe 3 me ngjyrë tjetër që përdoren vetëm në rast dëmtimi të vulave me ngjyrë të bardhë. Ky veprim dokumentohet me plotësimin, nënshkrimin dhe vulosjen e procesverbalit Model KZAZ 23, një kopje të së cilës e mban sekretari i KQV-së në një dosje të veçantë.
 - iii Listën e zgjedhësve. Ky veprim dokumentohet përmes procesverbalit të veçantë të përgatitur nga KZAZ. Lista e zgjedhësve do të përdoret nga KQV-ja ditën e votimit, për të numëruar nënshkrimet e tyre, në rast se PEI nuk funksionon.
- b) Pajisja elektronike e identifikimit PEI dhe kamera administrohet në KQV sipas udhëzimeve të posaçme të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit, në përputhje me pikën 5, të nenit 18 dhe të nenit 19 të vendimit nr.11/2021 të Komisionit Rregullator.
- Të gjitha procesverbalet mbahen në ruajtje nga sekretari i KQV-së.
- c) Kryetari i KQV-së, në praninë e anëtarëve të KZAZ-së, merr në dorëzim vulën e kryetarit të KQV-së sipas veprimeve të mëposhtme:
- i merr me zgjedhje rastësore një vulë nga grumbulli përkatës i vulave të paketuara;
 - ii gris ambalazhin e vulës;
 - iii vulos, në letër të bardhë për të bërë modelin e krahasimit të vulës;
 - iv shënon emrin në një letër dhe mbiemrin e tij, si dhe nënshkruan nën modelin krahasues të vulës;

Anëtarët e KZAZ-së nënshkruajnë në pjesën e pasme të letrës së bardhë me modelin krahasues (specimenin) e Vulës së Kryetarit të KQV-së dhe mbahet në ruajtje nga Sekretari i KZAZ-së në një dosje të veçantë.

2. Dërgimi i materialeve zgjedhore në qendrën e votimit

- a) KQV, për materialet e marra në dorëzim, kryen këto veprime:
- i vendos në qendrën e votimit, të ruajtur nga Policia e Shtetit. Asgjë prej këtyre materialeve nuk nxirren jashtë prej saj;
 - sistemon qendrën (tavolina, karrige) dhe mbyll dritaret dhe derën;
 - KQV nuk bën asnjë veprim me PEI në asnjë rast, madje as edhe në rast se operatori nuk paraqitet në detyrë.
 - vulos në prani të punonjësit të policisë të ngarkuar me shërbim në këtë QV, derën e qendrës së votimit. Simbolin mbi plastelinë e zgjedh vetë.

- b) KQV nuk mund të largohet nga qendra e votimit nëse punonjësi përkatës i policisë nuk është paraqitur dhe njofton KZAZ-në për mosparaqitjen e tij. Punonjësi i Policisë së Shtetit merr në ruajtje ambientin e qendrës së votimit pasi komisioni i qendrës së votimit sjell materialet zgjedhore. Ai largohet nga KQV-ja, në ditën e votimit, kur në qendrën e votimit paraqiten anëtarët e KQV-së për të kryer veprimet paraprake për fillimin e procesit të votimit.

VIII. Veprimtaria e KQV-së në ditën e votimit

1. Veprimet paraprake të KQV në ditën e votimit

- a) KQV dhe operatori paraqiten në orën 6.00 në qendrën e votimit.
- b) KQV kryen këto veprime paraprake:
- i kontrollon vulën e derës dhe materialet zgjedhore nëse janë të paprekura;
 - ii heq materialet propagandistike që mund të ndodhen në QV ose rreth saj në një rreze prej 150 m;
 - iii organizon qendrën e votimit (tryeza, karrige, dhomat e fshehta, vendin e vëzhguesve, afishimin e materialeve propagandistike që kanë marrë nga KZAZ, flamurin kombëtar). Organizimi i qendrës së votimit duhet të jetë në mënyrë që të krijojë akses për të gjithë pjesëmarrësit për të ushtruar të drejtat e detyrat e tyre, sipas skemës orientuese bashkëlidhur.
 - iv siguron që kamera për video regjistrim është në funksion. Kjo do të thotë që kamera regjistron pa pengesa veprimet dhe kryerjen e procedurave nga anëtarët e KQV-së dhe zgjedhësi dhe nuk cënon fshehtësinë e votës së zgjedhësit.
- c) Operatori vë në funksion pajisjen elektronike të identifikimit PEI si dhe kamerën duke iu referuar planvendosjes orientuese sipas skemës tip.

2. Veprimet paraprake të KQV-së për hapjen e votimit

- a) Operatori vë në funksion kamerën dhe procesi i regjistrimit fillon që në orën 6.00 dhe vijon pandërprerë deri sa KQV me kutinë e votimit dhe atë të materialeve zgjedhore largohen nga qendra e votimit.
- b) KQV, nën drejtimin e kryetarit dhe sekretarit, kryen këto veprime për hapjen e votimit:

- Hap kutinë me materiale zgjedhore dhe kontrollon/ inventarizon të gjitha materialet zgjedhore sipas procesverbaleve model KZAZ 22, model KZAZ 23 dhe procesverbalin e KZAZ për listën e zgjedhësve;
- Merr vendim për caktimin e detyrave të anëtarëve të KQV-së, sipas Model KQV10.
- U tregon vëzhguesve kutinë e votimit, të zbrazët.
- Vulos kutinë e votimit me katër vula me kode sigurie që të mos lejojë hapësira mes kutisë dhe kapakut të saj, sipas përcaktimeve në procesverbalin e vulosjes së kutisë së votimit, Model KQV 7.
- Konfirmon, pas aktivizimit të pajisjes PEI nga operatori teknik, numrin e qendrës së votimit, vendodhjen e saj si dhe numrin e zgjedhësve në listën e zgjedhësve të qendrës së votimit.
- Verifikon nëse informacioni që shfaqet në ekranin e pajisjes PEI është i njëjtë me të dhënat e QV. Nëse këto të dhëna janë të njëjta, autorizon operatorin të vijojë konfigurimin e pajisjes PEI. Operatori aktivizon kartën smart dhe më pas kërkon konfirmim nga KQV-ja për hapjen e procesit të identifikimit
- Pajisja PEI printon raportin e hapjes të procesit të identifikimit elektronik, ku numri i zgjedhësve identifikuar elektronikisht duhet të jetë 0. Ky raport nënshkruhet nga anëtarët e KQV-së dhe vulozet me vulën e KQV-së.
- Fut në kutinë e votimit, para fillimit të procesit të votimit zarfin e etiketuar “Zarfi i procesverbalit të vulosjes”, Model KQV 1 në të cilin futet origjinali i procesverbalit MODEL KQV 7 dhe raporti i hapjes së procesit të identifikimit elektronik, të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e KQV-së, të vulosur nga sekretari dhe mbyllur prej tij.
- Marrin vendimin për hapjen e votimit, sipas Model KQV 11.
- Përmes kryetarit, deklarojnë hapjen e votimit në orën 7.00

3. Procedura e votimit

- a) Zgjedhësi voton me një fletë votimi.
- b) Votimi fillon në orën 7.00.
- c) Zgjedhësi paraqitet me një nga dokumentet e vlefshme të identitetit (kartë identiteti/pasaportë biometrike). Një anëtar i KQV kontrollon duart nëse zgjedhësi është apo jo i timbrosur.

- d) Kryetari pasi verifikon se zgjedhësi është i njëjtë me personin në dokumentin e identitetit, dorëzon tek operatori, dokumentin e identitetit.
- e) Operatori skanon dokumentin e identitetit dhe përcakton nëse zgjedhësi është i regjistruar në listën e zgjedhësve të QV dhe nuk është identifikuar më parë. Pajisja PEI përmes ngjyrës jeshile në ekran vërteton se të dhënat e identitetit të zgjedhësit u lexuan me sukses. Operatori orienton zgjedhësin të depozitojë gjurmën e gishtit të madh të dorës së djathtë, në skanuesin e gjurmëve të gishtërinjve të PEI dhe ta riprovtojë disa herë kur në depozitimin e parë gjurma nuk u lexua nga PEI. Nëse pas kryerjes së këtyre veprimeve PEI nuk konfirmon depozitimin e gjurmës së gishtit të madh të dorës së djathtë të zgjedhësit, operatori teknik, përmes butonit “e palexueshme” mundëson depozitimin e gjurmëve të gishtërinjve të tjerë sipas orientimeve që shfaqen në ekranin e pajisjes PEI, duke riprovuar depozitimin.
- f) Operatori i dorëzon Kryetarit të KQV-së, dokumentin fizik/raportin, të printuar nga PEI, për kryerjen e identifikimit elektronik të zgjedhësit.
- g) Kryetari i KQV-së, administron dokumentin fizik të dorëzuar nga operatori në zarfin ku është shënuar “Vërtetime të identifikimit elektronik të zgjedhësve”.
- h) Një anëtar i KQV timbros gishtin e madh të dorës së majtë të zgjedhësit, me një lëndë të posaçme, të dukshme me shikim të lirë dhe që nuk hiqet për jo më pak se 24 orë.
Në rast se zgjedhësi nuk pranon të kryejë verifikimin elektronik, ose nënshkrimin biometrik me anë të gjurmëve të gishtave, atij nuk i jepet fleta e votimit.
- i) Zgjedhësit, i jepet fleta e votimit, e cila, në pjesën e pasme të saj, vuloset me vulën e KQV-së që administrohet nga sekretari dhe me vulën e kryetarit të KQV-së.
- j) KQV mundëson që zgjedhësi të hyjë dhe votojë i vetëm dhe i lirë në dhomën e fshehtë dhe vetëm duke patur fletën e votimit.
- k) Zgjedhësi del nga dhoma e fshehtë e votimit, me fletën e votimit të palosur në mënyrë që një nga vulat në pjesën e pasme të votimit të jetë e dukshme.
- l) Një anëtar i KQV-së orienton zgjedhësin, pasi ai del nga dhoma e fshehtë, të hedhë fletën e votimit në kutinë e votimit.
- m) Sekretari i KQV regjistron dhe dokumenton rastet e zgjedhësve që për arsye fizike nuk mund të votojnë vetë.

4. Veprime të KQV kur PEI nuk punon

- a) Operatori teknik i QV pasi prezanton problemin tek KQV, njofton menjëherë qendrën e asistencës teknike.
- b) KQV merr vendim për pezullimin e votimit dhe njofton menjëherë KZAZ
- c) Rifillimi i procesit duhet të ndodhë jo më vonë se tre orë nga koha e njoftimit në qendrën e asistencës teknike. Pas kalimit të tre orëve nga koha e njoftimit të qendrës së asistencës teknike, KQV merr vendim për të vijuar votimin pa kryerjen e identifikimit elektronik të zgjedhësve. Ky vendim i njoftohet menjëherë Komisionerit shtetëror të zgjedhjeve dhe KZAZ.
- d) Zëvendësimi i PEI kryhet në QV në prani të KQV, operatorit teknik dhe vëzhguesve dhe sekretari regjistron në librin e protokollit të dhëna të detajuara për pajisjen e re PEI.

Operatori teknik vijon identifikimin elektronik të zgjedhësve përmes PEI që u vu në punë.

5. Mbyllja e votimit

- a) Votimi mbyllet në orën 19.00 dhe askush nuk mund të votojë pas orës së mbylljes së qendrave të votimit me përjashtim të zgjedhësve që presin për të votuar në kohën e mbylljes.
- b) Një nga anëtarët e KQV mbledh dokumentet e identifikimit të zgjedhësve dhe i thërret me radhë ata për të kryer votimin. Votimi mbyllet pasi voton edhe zgjedhësi i fundit, i pranishëm.
- c) Votojnë të fundit:
 - Anëtarët e KQV-së.
 - Operatori teknik i QV-së/personi i ngarkuar për funksionimin e kamerës në rast se është pjesë e listës së zgjedhësve të asaj bashkie votojnë të fundit.
- d) KQV-ja merr vendim për mbylljen e votimit dhe plotësohet Model KQV 16.
- e) Operatori teknik mbyll procesin e identifikimit elektronik të zgjedhësve.
- f) PEI printon raportin e mbylljes (bashkëlidhur) i cili nënshkruhet nga anëtarët e KQV-së, vuloset nga sekretari dhe administrohet nga kryetari dhe pajisja PEI mbyllet në valixhe me vulë me kod sigurie. Kjo procedurë dokumentohet me plotësimin dhe nënshkrimin nga KQV të procesverbalit MODEL KQV 9.
- g) Kryetari deklaron me zë të lartë të dhënat për zgjedhësit dhe fletët e votimit dhe urdhëron sekretarin të plotësojë në të gjitha rubrikat procesverbalin për mbylljen e votimit, MODEL KQV 8.

6. Veprimet pas mbylljes së votimit

- a) Kryetari nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV-së fillon numërimin e fletëve të votimit të papërdorura dhe deklaron shifrën. Nëse kërkohet rinumërimi nga ndonjë anëtar i KQZ apo vëzhgues, ai rifillon sërish. Ky numër pasqyrohet në procesverbalin e mbylljes së votimit dhe këto fletë votimi futen në zarfin e fletëve të votimit të papërdorura.
- b) Kryetari nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV-së fillon numërimin e fletëve të votimit të dëmtuara dhe shifra pasqyrohet në procesverbalin përkatës dhe këto fletë votimi futen në zarfin e fletëve të votimit të dëmtuara. Nëse ka vërejtje, ato shënohen në librin e protokollit të mbledhjeve.
- c) Zarfat e mësipërme, zarfi “vërtetime të identitetit elektronik të zgjedhësve”, lista e zgjedhësve, vulat me kodet e sigurisë të papërdorura e të dëmtuara, vulat e KQV e të kryetarit, raporti i mbylljes PEI e libri i protokollit futen në kutinë e materialeve zgjedhore.
- d) Plotësohet procesverbali i mbylljes së votimit në të gjitha rubrikat e tij i cili së bashku me raportin e mbylljes së identifikimit elektronik të zgjedhësve futen në kutinë e votimit që mbyllet me vulat me kodet e sigurisë. Veprimet e tjera lidhur me procesverbalin janë të detajuara në këtë procesverbal.
- e) Kryetari, sekretari dhe operatori shoqëruar me punonjës të policisë dorëzojnë në KZAZ, jo më vonë se ora 22.00, kutinë e votimit, kutinë e materialeve zgjedhore dhe PEI. Ky veprim dokumentohet me procesverbalin Model KZAZ 24.
- f) Në rast se PEI nuk ka funksionuar dhe nuk është printuar raport me të dhëna për numrin e zgjedhësve, kryetari i KQV-së, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV-së: shënon numrin e zgjedhësve që janë identifikuar nga PEI sipas numrit të dokumenteve fizikë të administruara në zarfin “Vërtetime të identifikimit elektronik të zgjedhësve dhe deklaron shifrën. Kundërshtimet lidhur me shifrën plotësohen në procesverbalin e mbylljes së votimit. Çdo veprim që bëhet me PEI evidentohet në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.

IX. Rregulla në qendrën e votimit

1. KQV lejon në qendrën e votimit operatorin teknik të QV-së i emëruar nga KQZ, zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit dhe vëzhguesit e akredituar shqiptarë dhe të huaj sipas përcaktimeve për vëzhguesit (referoju nenit 6 dhe 7 të Kodit Zgjedhor). KQV, vëzhguesit, operatori apo personeli teknik i asistencës së pajisjes PEI duhet të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentin e identifikimit sipas funksionit që ata kanë të lëshuar nga KQZ/KZAZ dhe të kenë letërnjoftimin/kartën e identitetit ose pasaportën. Këto dokumente i verifikon sekretari i KQV. Vëzhguesit, në të gjitha fazat, mund të vëzhgojnë, të shohin dokumentacionin e procesit zgjedhor si dhe të paraqesin vërejtje me shkrim, por nuk mund të ndërhyjnë në procesin e votimit.
2. KQV lejon me vendim të tij hyrjen e largimin e personelit teknik të njoftuar për dhënien e asistencës teknike në rastin kur PEI ose kamera ka probleme të funksionimit si dhe të punonjësit të Policisë së Shtetit, kur janë duke ushtruar detyrën në përputhje me nenin 109 të KZ.
3. KQV nuk lejon përdorimin e telefonave celularë dhe kamerave të çdo lloji nga askush me përjashtim të:
 - a) Përdorimit të telefonit celular nga sekretari për komunikimet me KZAZ për hapjen e mbylljen e procesit të votimit si dhe për pjesëmarrjen në votim.
 - b) Filmimeve të shkurtra të procesit zgjedhor nga ana e medias së akredituar, por pa kompromentuar fshehtësinë e votimit. Fotografimi i fletës së votimit të shënuar është rreptësisht i ndaluar.
4. Në Librin e Protokollit të Mbledhjeve shënohet çdo largim i anëtarit të KQV apo i sekretarit. Kur kryetari apo sekretari largohet, çdo material dhe detyrë e tyre i delegohet një anëtar i me të njëjtën përkatësi politike.

X. Raste të veçanta votimi

1. Zgjedhësi që për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit, mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër. Të dy zgjedhësit duhet të jenë në listën e zgjedhësve të asaj QV-je dhe të pranishëm në qendrën e votimit. Verifikimin në listën e zgjedhësve të qendrës së votimit e bën Kryetari i KQV-së. Zgjedhësi që kërkon ndihmë për të votuar kryen identifikimin elektronik, ndërsa personi që do ta ndihmojë, para se të shënojë në fletën e votimit, bën një deklaratë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, në modelin

përkatës. Anëtarët e KQV apo operatori nuk mund të ndihmojnë asnjë zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.

2. Zgjedhësi që nuk shikon se mund të votojë vetë, duke përdorur shabllonin/maskën me alfabetin braille. Fleta e votimit futet plotësisht brenda shabllonit maskës me alfabetin braille, në mënyrë të tillë që çdo kuadrat për shënimin e zgjedhësit të përputhet me çdo kuadrat të maskës me alfabetin braille.
3. KQV lejon operatorin teknik të shtypë në mënyrë manuale të dhënat e zgjedhësit në ekranin e PEI, i cili nuk e ka emrin në listën e zgjedhësve të qendrës së votimit:
 - a) Zgjedhësi që paraqitet për të votuar me vendim gjykate, i cili i jep të drejtë të votojë në atë qendër votimi. Emri i zgjedhësit që paraqitet për të votuar me vendim gjykate shënohet nga KQV-ja në regjistrin e posaçëm, të cilit i bashkëngjitet vendimi.
 - b) Anëtarët e KQV-së
 - c) Anëtari i KZAZ i pajisur me vendim të saj
 - d) Operatori teknik i qendrës së votimit, në rast se është pjesë e listës së zgjedhësve të asaj bashkie.
 - e) Zgjedhësi, dokumenti i identitetit të të cilit është i dëmtuar dhe nuk lexohet nga PEI
 - f) Zgjedhësi që kryen identifikimin elektronik pa depozituar gjurmë të gishtërinjve. Zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve, dhe më pas atij i dorëzohet fleta e votimit, nëse ai pranon të timbrohet.

XI. Veprimet që çënojnë procesin e votimit

- a) Zgjedhësi në tentativë për votim të dyfishtë

Në rastin kur zgjedhësi që ka votuar më parë në atë QV, duke u identifikuar përmes PEI-t, tenton të kryejë sërish identifikimin elektronik:

- i KQV sinjalizohet përmes një tingulli të posaçëm dhe ngjyrës së kuqe që shfaqet në ekranin e PEI;
- ii PEI printon menjëherë vërtetimin me emrin, mbiemrin, numrin personal, datën e lindjes, dhe fotografinë e personit, orën kur ky person ka votuar në QV, me tekstin “tentativë për votim të dyfishtë”.

“Sekretari i KQV-së regjistron të dhënat e zgjedhësit në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, dhe pasi verifikon informacionin me dokumentin e printuar nga PEI dhënë nga

Operatori teknik/personi i autorizuar nga KQZ, e përcjell tek Kryetari i KQV-së. Dokumenti fizik i administrohet nga Kryetari i KQV-së në zarfin ku shënohet “*vërtetime të identifikimit elektronik të zgjedhësve*”.

b) Zgjedhësi që paraqitet në qendrën e votimit ku nuk është i regjistruar.

Në rastin kur zgjedhësi nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të QV-së:

- i KQV sinjalizohet përmes një tingulli dhe ngjyrës së verdhë që shfaqet në ekranin e PEI. Në ekran shfaqet numri i QV ku zgjedhësi është i regjistruar;
- ii PEI printon raportin me datën, orën, dhe numrin e QV-së ku zgjedhësi është i regjistruar, i cili i dorëzohet zgjedhësit për orientim. Ky është i vetmi rast kur zgjedhësit i jepet dokumenti i printuar.

Sekretari i KQV-së regjistron të dhënat e zgjedhësit në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.

c) Zgjedhësi voton jashtë dhomës së fshehtësisë, dëmton fletën e votimit pa dashje apo fotografon fletën e votimit në dhomën e fshëhtësisë:

- i. Fletët e votimit konsiderohen të dëmtuara dhe në pjesën e pasme të fletës së votimit kryetari shënon “e dëmtuar”. Ato nuk hidhen kurrë në kutinë e votimit, por administrohen në zarfin e fletëve të votimit të dëmtuara dhe zgjedhësit i jepet një fletë e re.
- ii. Nëse i njëjti veprim përsëritet nga zgjedhësi, fletët e votimit konsiderohen të dëmtuara dhe nuk hidhen kurrë në kutinë e votimit, por administrohen në zarfin e fletëve të votimit të dëmtuara dhe zgjedhësit nuk i jepet një fletë e re.

d) Votimi familjar dhe në emër të të tjerëve është i paligjshëm, apo prezenca e individëve me armë, përdorimi i celularëve apo pirja e duhanit.

e) Grumbullimi i personave në mjediset jashtë qendrës së votimit në një rreze prej 150 m, në oborr apo në korridoret e brendshme, përveç zgjedhësve, vëzhguesve, media e autorizuar apo personat e ngarkuar për sondazhe nga OJF të autorizuar nga KQZ, për këtë qëllim.

Krijimi i situatave të tilla është shkak për pezullimin e procesit dhe kërkimin e ndërhyrjes së policisë. Modelet e procesverbalet përkatëse gjenden në materialet zgjedhore që KQV ka marrë në dorëzim.

Skema e orientuese e KQV

